



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 117/2013

Prishtinë, më 10.9.2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N -302

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha -Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Etem Arifi.

Mungoi: Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi dhe Ilir Gashi- ZPRK; Dardan Abazi - INDEP; Fehmi Pireva-Kuvendi i Kosovës; Qëndresa Mrasori, praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 30.7.2013;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-220 për investimet e huaja;
4. Shqyrtimi i Rekomandimeve në lidhje me funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës - AKK;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 30.7.2013;

Procesverbali i mbledhjes së datës 30.0.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-220 për investimet e huaja;

Kryetari, theksoi se sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë të projektligjeve, komisionet funksionale i shqyrtojnë në parim projektligjet. Ai pastaj hapi debatin që t'i paraqesin vërejtjet në parim dhe kërkoi të formohet grupi i punës.

Teuta Sahatqija, tha se pasi që ky Projektligj për investimet e huaja është kthyer dy herë nga ana e Kuvendit në Qeveri dhe përsëri është sjellë nga Qeveria, por tani vetëm më disa ndryshime shumë të vogla apo kozmetike, dhe ku kemi ndryshim vetëm sa i përket ndryshimit të kapitalit nga kompania nga 25 në 10 %. Mirëpo, kemi vërejtje tek të neni 8, lidhur implikimet buxhetore si dhe tek trajtimi siç thuhet të përmbushjes së objektivave të integritit evropian, ndërsa në memorandumun shpjegues thuhet se investimet e huaja nuk janë pjesë e rregullimit të legjislacionit të BE-se sepse kjo çështje rregullohet veç e veç nga legjislacioni nacional. Po ashtu në dispozitat përfundimtare të projektligjit, thuhet së duhet të shfuqizohen dy ligje tjera që mund ta rregullojnë këtë fushë, por që në praktike është vështirë të ndodh sepse janë fusha të ndryshme e jo te njëjta. Sahatqija theksoi që në tërësi nuk kemi ndonjë ndryshim thelbësorë të Projektligjit për investimet e huaja nga draftet e mëparshme dhe si grup parlamentar, jemi kundër miratimit të këtij projektligji.

Visar Ymeri, tha që pajtohet me znj. Sahatqija, që tani Projektligji për investimet e huaja i ardhur përsëri nga Qeveria nuk ka ndonjë ndryshim substancial. Ymeri theksoi se nuk janë marrë për bazë rekomandimet deputetëve në debatin e zhvilluar të dy seanca ku i është kthyer Qeverisë projektligji në fjalë. Për investimet e huaja, tha që rregullat janë të ndryshme edhe në disa shtete të BE-së, dhe kemi një lloji dallimi në mes të investitorëve të huaj dhe vendorë. Prandaj, në Projektligjin për investimet e huaja, duhet të vendosen disa rregulla dhe kritere që të mos përzihen më investimet vendore, duke theksuar se si grup parlamentar, jemi kundër miratimit në parim të këtij projektligji.

Myzejene Selmani, megjithëse u pajtua me konstatimet e parafolësve, ajo tha se tani në Komision duhet vet ta formojmë një grup të punës dhe ta amendamentojmë këtë projektligj ngase vendit tonë i duhen më shumë së kurrë investitorët e huaj dhe neve si deputetë e kemi obligim të hartojmë ligje që tërheqin investimet e huaja. Në fund kërkoi që të miratohet në parim Projektligji për investimet e huaja.

Shaip Muja, tha se s'ka qenë anëtarë i këtij Komisioni kur është kthyer dy herë dhe nuk i di shumë arsyet pse është kthyer prapa ky projektligj. Mirëpo, kërkoi që Komision të merret më me përkushtim me këtë projektligj, pasi që rregullon një fushë mjaft të rëndësishme dhe propozoj që të kërkohet edhe asistencë profesionale ndërkombëtare dhe të angazhohen edhe ekspertë të kësaj fushe që të kemi ekspertiza gjatë hartimit të amendamenteve. Kërkoi të miratohet në parim Projektligji për investimet e huaja.

Kryetari, theksoi që pajtohet me konstatimet që nuk ka ndonjë ndryshim të madh me dy versionet që i ishin kthyer Qeverisë nga ana e Kuvendit. Por kërkoi që ky projektligj të procedohet sipas procedurave për shqyrtimit në parim për seance plenare, pastaj që grupit punues gjatë amendamentimit t'i lihet hapësirë më e madhe, që të ketë kohë më shumë që të merren praktikat më të mira, në mënyrë që ta kemi një Ligj për investimet e huaja më praktik dhe më të përshtatshëm gjatë zbatimit.

Pas debatit Komisioni me gjashtë (6) vota Për, katër (4) Kundër, nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-220 për investimet e huaja.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-220 për investimet e huaja.

Komisioni nxori këtë

V E N D I M

1. *Formohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 04/L-220 për investimet e huaja;*
2. *Grupi punues ka këtë përbërje: Myzejene Selmani, raportuese, Teuta Sahatqia, Sala Berisha - Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku dhe Visar Ymeri;*
3. *Secili anëtarë i Komisionit, sipas interesimit mund ti bashkëngjitet Grupit punues gjatë punës së tij;*
4. *Grupi punues në bashkëpunim me Njësinë Koordinuese të Komisionit të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

4. Shqyrtimi i Rekomandimeve në lidhje me funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës – AKK;

Kryetari, tha se pasi që këtë pikë e kemi shqyrtuar edhe në mbledhjet e kaluara dhe ju kemi drejtuar Kryesisë së Kuvendit me rekomandime, lidhur me funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, me 5 Rekomandime, që të jetë më funksional ky Autoritet. Por tani kemi një këshillë juridike nga ana Sekretarit të Kuvendit, që rekomandimi nr. 3, të ndryshohet. Po ashtu iu kam drejtuar edhe Agjencisë Kundër Korrupsionit, për të marrë përgjigje në lidhje me konfliktin e mundshëm të interesit të dy anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës. Nga Agjencia kam një letër në të cilën thuhet se “angazhimi në institucionet arsimore, të zyrtarëve të lartë publik, nuk paraqet konflikt interesi.

Sala Berisha-Shala, tha që me këshillën juridike që ka ardhur nga Sekretari i Kuvendit, nuk pajtohet që mund të propozohet që të ketë ndarje të funksionimit të Bordit dhe të Stafit të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, pasi që kjo çështje rregullohet me Ligj dhe Statut për mbrojtjen e konkurrencës. Ajo tha se Neni 25, paragrafi 3, i ligjit e thotë qartë se kush e menaxhon këtë Autoritet. Ajo theksoi që ndryshime të tilla mund të bëjmë vetëm atëherë kur bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Lutfi Zharku, tha së pajtohet me mendimin e deputetes Sala Berisha - Shala dhe në parim është që të mbeten rekomandimet e Komisionit të datës 24 korrik, pasi që këto rekomandime janë në harmoni më Ligjin dhe Statutin e AKK-së, dhe kërkoj që mos të ndryshohen sepse është i panevojshëm ndryshimi i tyre.

Visar Ymeri, theksoi pasiqë Bordi i AKK-së, nuk është i kompletuar tash sa kohë edhe më dy anëtar, atëherë kemi një Bord që nuk është funksional, pasiqë në shumicën e vendimeve që merren, duhet të ketë votim e jo vetëm të mbetet që vendimet të merren me votim afirmativ. Ai tha, që edhe emërimi i Ushtruesit të Detyrës së Kryetarit të AKK-së nuk ekziston në Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës dhe pyeti se kush e ka emëruar atë dhe s'ka bazë ligjore për UD të kryetarit të Bordit. Ymeri theksoi se sipas logjikës dhe legjislacionit në fuqi punët edhe përgjegjësitë e Bordit dhe stafit administrativ të AKK-së, duhet të jenë të ndara në bazë të fushëveprimtarisë sepse Bordi merret me çështjet profesionale dhe me kompetencë të gjerë, ndërsa Sekretari i AKK-së, me çështjet administrative, resurse humane, logjistikë etj.

Kryetari, tha se kemi shumë agjenci që funksionojnë në mënyra të ndryshme, por ne si Komision Funksional që e mbikëqyrim punën AKK-së, duhet që rekomandimet tona të jenë në përputhje më Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës. Ai tha se për rekomandimet e datës 24.7.2013, jemi pajtuar dhe në fund kërkoj që të votohet propozimi për ndryshimin e rekomandimit nr.3, në bazë të këshillës juridike.

Pas debatit, Komisioni nuk e miratoi ndryshimin e propozuar të Rekomandimit Nr.3, për shkak se votuan me një (1) Për, gjashtë (6) Kundër dhe tre (3) Abstenime.

Komisioni autorizoi kryetarin e Komisionit, që të njoftojë Kryesinë e Kuvendit për mosndryshimin e Rekomandimeve të datës 24.7.2013, lidhur me funksionimin e AKK-së.

5. Të ndryshme.

Çështjet vijuese

Sala Berisha- Shala, propozoj që mbledhjen e radhës të hynë në rendin ditës shqyrtimi i hartimit të Projektligjit për shërbimin gjeologjik, për shkak se ne si Komision e kemi parapa në planin e punës dhe poashtu në planin e punës të Kuvendit.

Komisioni u pajtua me propozimin e deputetes znj.Sala Shala – Berisha.

Shaip Muja, Propozoj që të ftohet në Komision për raportim znj, Mimoza Kusari -Lila, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, lidhur më vendimin e marrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për masat e ndalimit tregtar të mallrave nga Republika e Maqedonisë. Por, kërkoj që paraprakisht ta dërgojnë edhe një raport zyrtar, lidhur me vendimet që i ka ndërmarrë MTI-ja deri me tani në lidhje më këtë çështje.

Komisioni u pajtua me propozimin e deputetit z .Shaip Muja.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Kryetar i Komisionit,
Zenun Pajaziti**